



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Syllabusi i lëndës: Financat Personale

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Financat Personale
Niveli:	Bachelor
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	II (semestri III)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësit e lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda "Financa Personale " është një nga lëndët e formimit bazë për studentët e nivelit bachelor në programin Menaxhim Biznesi. Ajo jep njohuritë fundamentale për formimin me kulturën e Financave Personale të gjithë studenteve e Fakultetit të Biznesit. Duke i shërbyer këtij qëllimi, programi i lëndës ka për objektiv të formojë studentët me koncepte dhe njohuri të qëndrueshme në fushën e: sigurimeve dhe financave personale. Në këtë modul trajtohen gjerësisht konceptet dhe kategoritë e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimeve & taksave, duke u paraqitur në kontekstin e pasqyrës së financave personale, veprimet bankare dhe normat e interesit, menaxhimit të parave, vlerësimit, sigurimit. & menaxhimit të kredisë, huasë personale, blerjes dhe financimit të një shtëpie, sigurimit të automjeteve dhe pronarëve të shtëpive, sigurimit të shëndetit dhe paaftësisë për punë, planifikimit të trashëgimisë etj. Gjithmonë të para nga këndvështrimi i individit.
Qëllimet e lëndës:	Studenti të jete në gjendje: 1. Të njohë, të vlerësojë gjendjen financiare të familjes. 2. Të përshkruajë mjedisin familjar me të hyrat dhe të dalat e tij. 3. Të përshkruajë situatën familjare në gjendjen e kredive nga të dy bashkeshortët. 4. Të përshkruajë vizionin e familjes dhe objektivat e saj afat-shkurtër dhe afat-gjatë. 5. Të njohë, përshkruajë, vlerësojë dhe analizojë

	gjendjen e brendshme të familjes duke u ndalur në hartimin e Bilancit Familjar dhe Pasqyrës së të Ardhurave. 6. Të identifikojë faktorët që ndikojnë në rritjen/zvogelimin e të ardhurave familjare. 7. Të njohë dhe të mundë të operojë me disa prej llojeve të strategjive të menaxhimit të borxhit. 8. Të jete në gjëndje të marrë vendim mbi sasinë e huasë që duhet të marrë dhe me mënyrat e ndryshme që duhen përdorur për të marrë hua. 9. Të jetë në gjëndje të vlerësojë rolin e "Rritjes" intelektuale e profesionale si dhe ndikimin e tij në të ardhurat e familjes. 10. Vlerësimi i Institucioneve të Sigurimit të Pasurive, Sigurimit të Jetës, etj. 11. Të jetë në gjëndje të dhe të diskutojë rreth faktorëve që ndikojnë mbi mundësinë e sigurimit të pronave apo automjeteve. 12. Të përshkruaje se sa i nevojshem është siguri i pensionit nga shoqëritë e sigurimit. 13. Të arrijë të përshkruajë të ardhurat që i nevojiten në moshën e pensionit. Problemet shëndetësore dhe kujdesi shëndetësor që duhet mbuluar nga këto kompani për moshën e tretë. 14. Të njoh dhe të analizojë kompanitë më të mira për të investuar fondet rezervë. 15. Të spjegojë nevojën e përdorimit të kartave të kreditit/ debitit. Pse ato janë të nevojshme? Insitucionet që i emetojnë? Si duhet të përdoren? 16. Familjarizimi me pagesat e faturave on-line. Përse janë të nevojshme. Mënyra e pageses. Institucionet financiare që i aplikojnë.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studimi dhe përvetësimi i informacionit të ofruar përmes këtij moduli bën të mundur që studenti të zotërojë kompetencat e nevojshme në lidhje projektimin, ndërtimin dhe implementimin e një buxheti familjar. Strategjitë që familja duhet të implementojë për të rritur të ardhurat e saj. Studentët do të jete në gjëndje për t'u angazhuar me sukses në fushën e ndryshme të menaxhimit të buxhetit të tyre, për të organizuar me mirë jetën familjare. Studentët do të jenë në gjëndje të artikulojnë (edhe në situata të komplikuar) problemet dhe të ofrojnë opinione për zgjidhjen e tyre, në situatë kerdie të keqe, situatë borxhi, etj. Metodat e investimit të fondeve të tepërta në Insitucione finaciare jo-bankare.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30

Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	2	5	10
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	10	1	10
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	10	1	10
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	• Prezantimi i temës mësimore në Power Point • Përsëritja e temës paraprake nga grupi i caktuar i studentëve, analiza dhe diskutime • Rast studimi apo detyrë (për orën e ushtrimeve) lidhur me temën e ligjëruar		
Metodat e vlerësimit:	• Testi i parë vlerësues: 0 – 40% • Testi i dytë vlerësues: 0 – 40% • Punimi seminarik: 0 – 10% • Interaktiviteti (ushtrimet): 0-10% • Provimi përfundimtar 0 - 80%		
Literatura			
Literatura bazë:	▪ Arthur J. Keown & Brikena Leka & Perseta Grabova – Financat Personale, Botimi i Shtatë, AADF, Tiranë, 2020.		
Literatura shtesë:	▪ Jack Kapoor, Les Dlabay, Robert J. Hughes, Melissa Hart - Focus on Personal Finance, McGraw-Hill/Irwin Series I Finance, Insurance, and Real Estate, 2015. ▪ Glencoe McGraw-Hill - Business and Personal Finance, Student Edition, Business & Economics - Management & Leadership, 2007.		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje (Prezantimi i lëndës, metodat e punës dhe vlerësimit)
Java e dytë:	Procesi i planifikimit financiar
Java e tretë:	Vlerësimi i mirëqenies suaj financiar dhe hartimi i një plani financiar
Java e katërt:	Menaxhimi i tatimeve dhe taksave
Java e pestë:	Menaxhimi i mjeteve monetare ose i aktiveve likuide
Java e gjashtë:	Përdorimi i kartave të kreditit: Roli i kredisë së hapur
Java e shtatë:	Huat për studentët dhe konsum: Roli i huamarrjes së planifikuar
Java e tetë:	Vendimmarja për banesën dhe automjetin Testi i parë vlerësues
Java e nëntë:	Sigurimi i jetës dhe shëndetit
Java e dhjetë	Sigurimi i pronës dhe i përgjegjësi
Java e njëmbëdhjetë:	Bazat e investimeve
Java e dymbëdhjetë :	Investimi në aksione
Java e trembëdhjetë:	Investimi në obligacione dhe në alternativa të tjera
Java e katërmëdhjetë:	Fondet e përbashkëta: Një mënyrë e thjeshtë për diversifikim
Java e pesëmbëdhjetë:	Planifikimi për pension: Rasti i Kosovës dhe planifikimi i pasurisë Testi i dytë vlerësues

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Cakto politikat e mirësjelljes konform statusit të UHZ-së. • Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore; • Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i

vëmendshëm në orën mësimore;

- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit dhe mjetit të identifikimit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqëndrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.